

KIS Interpretimi 29

Marrëveshjet e Koncesionit për Shërbimet: Dhënia e informacioneve shpjeguese

Referencat

- SNRF 16 *Qiratë*
- SNK1 *Paraqitja e pasqyrave financiare* (ndryshuar në 2007)
- SNK 16 *Aktivet afatgjata materiale (Toka, ndërtesa, makineri e pajisje)* (rishikuar në 2003)
- SNK 37 *Provizionet, detyrimet e kushtëzuara dhe aktivet e kushtëzuara*
- SNK 38 *Aktivet jo-materiale* (i rishikuar në vitin 2004)
- KIRFN 12 *Marrëveshjet koncesionare të shërbimit*

Çështja

- 1 Një njësi ekonomike (operatori) mund të lidhë një marrëveshje me një tjetër njësi ekonomike (dhënësi i koncesionit) për të siguruar shërbime që i japin mundësi publikut të shfrytëzojë lehtësirat ekonomike dhe shoqërore. Dhënësi i koncesionit mund të jetë një njësi ekonomike e sektorit privat ose atij publik, përfshirë një organ qeveritar. Shembuj të marrëveshjeve të koncesionit për shërbimet përfshijnë ato për lehtësirat e furnizimit dhe të trajtimit të ujit, autostradat, vend parkimet, tunelet, urat, rrjetet e aeroporteve dhe telekomunikacionit. Shembuj të marrëveshjeve që nuk janë marrëveshje të koncesionit për shërbime përfshijnë një njësi ekonomike që ofron mundësinë e shfrytëzimit të shërbimeve të saj të brendshme (p.sh. bar kafe për punonjësit, mirëmbajtja e ndërtesës dhe funksionet e kontabilitetit dhe të teknologjisë së informacionit).
- 2 Një marrëveshje koncesionare shërbimi në përgjithësi përfshin dhënësin e koncesionit që i kalon operatorit për periudhën e koncesionit:
 - (a) të drejtën e kryerjes së shërbimeve që i japin publikut mundësinë të shfrytëzojë lehtësirat kryesore ekonomike dhe shoqërore, dhe
 - (b) në disa raste, të drejtën për të përdorur aktivet materiale të specifikuara, aktivet jomateriale, ose aktivet financiare,
 në këmbim që operatori nga ana e tij:
 - (c) të angazhohet për të siguruar shërbime në lidhje me disa terma dhe kushte gjatë periudhës së koncesionit, dhe
 - (d) kur është e mundur, të kthejë në fund të periudhës së koncesionit të drejtat e marra në fillim të kësaj periudhe dhe/ose të përfuara gjatë periudhës së koncesionit.
- 3 Karakteristika e përbashkët e të gjitha marrëveshjeve të koncesionit për shërbimet është që operatori merr një të drejtë dhe ka një detyrim për të kryer shërbime publike.
- 4 Çështja është se çfarë informacioni shpjegues duhet të jepet në shënimet në pasqyrat financiare të një operatori dhe një koncesion dhënësi.
- 5 Disa aspekte dhe dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me disa nga marrëveshjet e koncesionit për shërbimet, tashmë, janë trajtuar nga Standardet ekzistuese të Raportimit Financiar (p.sh. SNK 16 zbatohet për zërat toka, ndërtesa, makineri e pajisje, SNRF 16 zbatohet për qiratë e aktiveve dhe SNK 38 zbatohet për blerjet e aktiveve jomateriale). Megjithatë, një marrëveshje koncesioni për shërbime mund të përfshijë kontratat përmbarese që nuk janë trajtuar në Standardet e Raportimit Financiar, me përjashtim kur ato janë detyruese, rast në të cilin zbatohet SNK 37. Prandaj, ky Interpretim trajton dhënie e informacioneve shpjeguese shtesë për marrëveshjet e koncesionit për shërbimet.

Konsensusi

- 6 Për të përcaktuar informacionin e duhur shpjegues që jepet në shënimet do të trajtohen të gjitha aspektet e një marrëveshje koncesioni për shërbime. Në çdo periudhë, një operator dhe një koncesion dhënës do të japin informacionin shpjegues të mëposhtëm:
- (a) një përshkrim të marrëveshjes;
 - (b) termat e rëndësishëm të marrëveshjes që mund të ndikojnë në shumat, afatin dhe në sigurinë e flukseve monetare (p.sh. periudha e koncesionit, datat e rivendosjes së çmimit dhe bazën mbi të cilën përcaktohet rivendosja ose ri negocimi i çmimit);
 - (c) natyra dhe shtrirja (p.sh. sasia, periudha kohore ose shuma e duhur) e:
 - (i) të drejtave për të përdorur aktivet e specifikuar;
 - (ii) detyrimeve për të siguruar ose të drejtave për të kërkuar sigurimin e shërbimeve;
 - (iii) detyrimeve për të përfutur ose ndërtuar zërat toka, ndërtesa, makineri e pajisje;
 - (iv) detyrimeve për të dorëzuar ose të drejtave për të marrë aktivet e specifikuar në fund të periudhës së koncesionit;
 - (v) opsioneve të rinovimit dhe të përfundimit; dhe
 - (vi) të drejtave dhe detyrimeve të tjera (p.sh. kontrollet e përgjithshme);
 - (d) ndryshimet që ndodhin në marrëveshje gjatë periudhës; dhe
 - (e) si janë klasifikuar marrëveshjet e shërbimit.
- 6A Një operator do të japë informacion shpjegues për shumën e të ardhurave dhe fitimeve ose humbjeve të njohura nga kryerja e shërbimeve të ndërtimit në këmbim të një aktivi financiar ose një aktivi jomaterial.
- 7 Në përputhje me paragrafin 6 të këtij Interpretimi, informacioni shpjegues kërkohet të jepet veças për çdo marrëveshje koncesioni për shërbime ose në total për secilën klasë të këtyre marrëveshjeve. Një klasë është një grupim i marrëveshjeve të koncesionit për shërbime të të njëjtës natyrë (p.sh. mbledhja e taksave, shërbimet e telekomunikacionit dhe të trajtimit të ujit).

Data e Konsensusit

Maj 2001

Data e hyrjes në fuqi

Ky Interpretim hyn në fuqi më 31 dhjetor 2001.

Një njësi ekonomike do të zbatojë ndryshimin në paragrafin 6(e) dhe 6A për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2008. Nëse një njësi ekonomike zbaton KIRFN 12 për një periudhë më të hershme, ndryshimi do të zbatohet për këtë periudhë më të hershme.

SNRF 16, i publikuar në janar 2016, ndryshoi paragrafin 5. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 16.